

Specifikimet Teknike

“Blerje Kamioncinë me karroceri për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të riciklueshme (karton dhe plastikë)”.

- Automjet transporti mallrash, kategoria N1.
- Pesha maksimale e lejuar: deri në 3500 kg.
- Karburanti: Diesel.
- Modeli: jo më i vjetër se viti 2009.
- Kambio manuale.
- Mjeti të jetë i pajisur me karroceri të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të riciklueshme (karton dhe plastikë).
- Karrocerie të jetë metalike, në gjendje të mirë pune dhe e përshtatshme për ngarkim dhe shkarkim manual.
- Motori, transmisioni, sistemi i frenimit, drejtimit, ndriçimit dhe pajisjet e sinjalizimit të jenë funksionale, pa defekte dhe conform rregullave dhe standarteve të Bashkimit European.
- Gomat të jenë në gjendje të mirë pune.
- Numri i vendeve: minimumi 3.
- Mjeti të dorëzohet me dokumentacion të rregullt, të regjistruar me targa shqiptare, me taksat dhe siguracionin në fuqi.
- Mjeti duhet të jetë i pajisur me manualet e operimit dhe servisimit.
- Airbag për shoferin dhe pasagjerin.

Garancia dhe shërbimi pas shitjes

- Mjeti duhet të jetë i mbuluar me një garanci teknike dhe shërbimi, një vit nga dita e marrjes në dorëzim
- Certifikata dhe targa shqiptare: Mjeti duhet të jetë e regjistruar me targa shqiptare, kolaudim, taksa dhe siguracion, gati për përdorim.
- Ofertuesi duhet të konfirmojë një servis i cili është operues në territorin e Shqipërisë duke dhënë adresën ose adresat ku mund të kryhen shërbimet e pas shitjes. Ky servis te pergjigjet ne rast difekti si dhe te jetë përgjegjës për mbulimin e te gjitha shërbimeve gjatë periudhës së garancise 12 muaj (në vendodhjen e mjetit).
- Periudha, e lëvrimit maksimum 10 (dhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- Çmimi i Kamioncinës me Karroceri përfshin transportin deri në objekt.

Argumentim: Specifikimet teknike janë vendosur duke u bazuar në VKM NR.285, datë 19.5.2021, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, neni 40 pika 2 ku përcaktohet se: “Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme

përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara” si duke u bazuar në nenin 36, të LPP-së.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike të hartuara janë të domosdoshme për të garantuar mallin dhe cilësinë e kërkuar.